



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:572/26 Datë: 30.04.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 148 të mbajtur më 20.04.2026, mori:

V E N D I M

I. Akreditohet programi i studimeve i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):

1. Cloud and Edge Computing, Msc (120 ECTS) me kuotën maksimumi 35 studentë për vit akademik.

II. Rikreditohet programi i studimeve i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2031):

2. Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Bsc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 160 studentë për vit akademik.

III. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.

IV. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

V. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.

VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Cloud and Edge Computing, Msc (120 ECTS) me kuotën maksimumi 35 studentë për vit akademik.	Luan Gashi Luan Mulaku
2.	Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri ,Bsc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 160 studentë për vit akademik.	Artan Rexhepi Bertan Ujkani Faton Merovci

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Cloud and Edge Computing, Msc (120 ECTS) vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 24.02.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri ,Bsc (180 ECTS) vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 24.02.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 148-të, të mbajtur më datë 20.04.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekipi i ekspertëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

